


JAVNO ПРЕДПРИЈАТИЕ УЛИЦИ И ПАТИШТА
NDËRMARRJES PUBLIKE RRUGË DHE RRUGICAT

Бр.-Нг. 02-6900/6

20.12. 2019 год. врт

СКОПЈЕ-ШКУП



NDËRMARRJA PUBLIKE "RRUGËT DHE RRUGICAT"- Shkup

Propozues:
Drejtori i ndërmarrjes publike
"Rrugët dhe rrugicat" – Shkup

PROGRAM

**PËR MIRËMBAJTJEN E SHTRATIT TË LUMIT VARDAR, DEGËVE TË TIJ, LUMENJVE
LEPENC, TRESKA, SERAVA DHE KANALEVE TË HAPURA NË TERRITORIN E
QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN 2020**

Shkup, dhjetor viti 2019

Në bazë të nenit 7 pika 3 të Ligjit për veprimtari komunale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 95/12, 163/13 dhe 42/14), pika IV e Planit zhvillimorë për mirëmbajtjen e shtratit të lumit Vardar, degëve të tij dhe të kanaleve të hapura në territorin e Qytetit të Shkupit për periudhën e viteve 2020-2022 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit") dhe neni 27 i Statutit të NP "Rrugët dhe rrugicat", Këshilli Drejtues në seancën e njëzetetë të mbajtur më datën 20 dhjetor të vitit 2019, solli këtë:

PROGRAM

PËR MIRËMBAJTJEN E SHTRATIT TË LUMIT VARDAR, DEGËVE TË TIJ, LUMENJVE LEPENC, TRESKA, SERAVA DHE KANALEVE TË HAPURA NË TERRITORIN E QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN 2020

I. Hyrje

Në territorin e qytetit të Shkupit rrjedh lumi Vardar, me degët e tij: Lepenci, Treska dhe Serava si dhe ekziston sistem i kanaleve të hapura të cilat i pranojnë dhe largojnë ujërat atmosferik, ujërat e zeza dhe ujëra të tjera.

Në shtratin e lumenjve dhe kanaleve mbledhet rërë, lym, degë si dhe mbeturina komunale dhe ndërtimore të cilat e vështirësojnë funksionimin e tyre përkatësisht pranimin dhe largimin e ujërave.

Me këtë Program definohehen aktivitetet e nevojshme për mirëmbajtje të shtratit minor të lumit Vardar, degëve të tij dhe të kanaleve të hapura të Qytetit të Shkupit në pjesën urbane të qytetit të Shkupit.

Mirëmbajtja e pjesës së shtratit të poshtëm të lumit Vardar vlen për pjesën e urës së re në Saraj deri në urën hekurudhore në fshatin Lisiçe e Epërme.

Në Programin përcaktohen aktivitetet e planifikuara për lokalitetet e dhëna si dhe mënyra e financimit për vitin 2020.

Në territorin e pothuajse të gjitha komunave në Qytetin e Shkupit, ekzistojnë deponi informale. Deponitë janë shumë vjeçare, me lloje të ndryshme të mbeturinave dhe gjenden në lokalitete të ndryshme.

Pas pastrimit të tyre, planifikohet që Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me komunitat të pengojë përgjithmonë përtëritjen e tyre përmes ri kultivimit të hapësirës dhe fisnikërimit e saj me gjelbërim.

II. Aktivitetet e planifikuara

1. Mirëmbajtje e shtratit të poshtëm të lumit Vardar

Mirëmbajtja e shtratit të bregut të majtë dhe të djathtë të lumit Vardar është paraparë të zhvillohet në tre faza edhe atë:

- **Faza e parë – pastrim manual**

Pastrimi manual i pjerrtësisë së shtratit dhe spërkatja me herbicide, nënkupton mënjanim të vegjetacionit të ulët në tërësi (shkurreve, barit, rrënjëve, gjembave dhe vegjetacionit tjetër) si dhe mbledhje të ambalazhit të plastikut.

- **Faza e dytë – pastrim me makineri i vegjetacionit me dorës elevatori**

Pastrimi i vegjetacionit do të realizohet me automjet në të cilin është montuar dorës elevatori. Vegjetacioni i prerë do të mbledhet në mënyrë manuale, do të ngarkohet në kamion dhe do të transportohet deri te lokaliteti përkatës.

- **Faza e tretë – pastrim me makineri, ngarkim dhe transportim**

Pastrimi me makineri është në funksion të rregullimit të shtratit të lumit dhe me këtë nënkuptohet largim i lymishtës së suspenduar nëpër pjerrtësitë dhe nivelet e lumit Vardar. Për realizimin e të njëjtit është e nevojshme që të vendosen pengesa të përkohshme mbeturinash që të mundësohet hyrje e mekanizimit të nevojshme në shtratin e lumit. Lymishta e injerrë, lymi dhe materiali tjetër do të ngarkohet në kamion dhe do të transportohet deri te lokacioni përkatës, përkatësisht në deponi.

- **Faza e katër - pastrim me makineri i rërës së mbledhur dhe lymit**

Heqja makinerike me buldozer e rërës së mbledhur dhe lymit përfshin mbulimin e gropave dhe sheshimin e niveletave të shtratit të lumit. Për realizimin e të njëjtës është e nevojshme të vendosen barriera degësh që të mundësohet hyrje e mekanizimit të nevojshëm në shtratin e lumit.

- **Faza e pestë – Sanimi i pjerrësirave të mureve të shtratit**

Kjo fazë nënkupton pastrimin e fugave në gurin e murosur të pjerrësirave të shtratit, fugimi i tij dhe zëvendësimi i gurëve të dëmtuar dhe i gurëve që mungojnë me gurë të rinj.

Pastrimi i fugave do të realizohet me kompresorë me pompë me presion të lartë, gjatë kësaj rrënjët e mëdhenj do të mënjanojnë në mënyrë manuale. Pjesët e dëmtuara të pjerrësirave do të sanohem përmes furnizimit, përpunimit dhe vendosjes së blloqeve të gurëve me d 30 cm me llaç të çimentos. Më pas do të pasojë larja e gurit me cisternë dhe lyerja me lidhje Y.

2. Mirëmbajtja e shtretërve të degëve të lumit Vardar: Lepenci, Treska dhe Serava

- **Faza e parë – pastrim manual**

Pastrimi manual i pjerrtësisë së shtratit nënkupton prerje dhe largim të drunjve, shkurreve, vegjetacionit tjetër të ulët si dhe mbledhje të ambalazhit të plastikut.

- **Faza e dytë – pastrim me makineri i vegjetacionit me dorës elevatori**

Pastrimi i vegjetacionit do të realizohet me automjet në të cilin është montuar dorëz elevatori. Vegjetacioni i prerë do të mbledhet në mënyrë manuale, do të ngarkohet në kamion dhe do të transportohet deri te lokaliteti përkatës.

- **Faza e tretë – pastrim me makineri, ngarkim dhe transportim**

Me pastrimin me makineri është parashikuar që të largohen rëra e mbledhur, lymi, hedhurinat, dheu dhe materiali tjetër nëpër pjerrtësitë dhe nivelet e shtretërve të lumenjve.

Nëse paraqitet nevoja në lokacione të veçanta do të vendosen pengesa të përkohshme mbeturinash që të mundësohet hyrje e mekanizimit të nevojshme në shtratin e lumit. Lymishta e nxjerrë, lymi dhe materiali tjetër do të ngarkohet në kamion dhe do të transportohet deri te lokacioni përkatës, përkatësisht në deponi.

- **Faza e katër - shtyrja me makineri e rërës së mbledhur dhe lymit**

Shtyrja makinerike – me buldozer e rërës së mbledhur dhe lymit përfshin mbulimin e gropave dhe sheshimin e niveletave të shtratit të lumit. Do të zhvillohet në lokacioni ku do të paraqitet nevoja dhe ku do të ketë kushte për realizim. Me këtë aktivitet do të mundësohet rregullim më i mirë i shtratit të lumit.

3 Mirëmbajtje e kanaleve të hapura në territorin e qytetit të Shkupit

Mirëmbajtja e kanaleve të hapura është parashikuar që të zhvillohet përmes këtyre fazave:

- Prerje manuale e vegjetacionit të ulët
- Pastrim manual i dheut dhe mbeturinave komunale nën urat dhe në lokalitetet ku nuk ekziston mundësia për qasje të mekanizimit dhe pastrimit me makineri
- Pastrim me makineri të vegjetacionit me dorëz elevatori
- Gërmim mekanik i materialit të mbledhur, tharje dhe ngarkim makinerik dhe transport deri në 12 km.

Aktivitetet e planifikuara për lokacion të veçantë do të zhvillohen pas urdhrit paraprak për punë i dhënë nga Sektori për punë komunale.

4. Pastrimi i deponive informale në territorin e Qytetit të Shkupit

Në lokalitete të ndryshme ku do të përcaktohet ekzistimi i deponive informale, në makinerike do të realizohet pastrimi i mbeturinave të ndryshme, ngarkimi dhe transportimi i tyre deri te Deponia Drislla për mënjanim afatgjatë.

IV. Financimi

Financimi i Programit kryhet nga mjetet për këtë qëllim të cilat do të sigurohen me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2020.

Çmimet e veçanta në bazë të cilave realizohet pagesa e situatave kohore dhe e faturave, janë përcaktuar në çmimoren e sjell nga Këshilli drejtues i NP "Rrugët dhe rrugicat" – Shkup, të miratuar nga Këshilli i Qytetit të Shkupit.

V. Realizues

Realizues i aktiviteteve të parapara me Programin do të jetë NP "Rrugët dhe rrugicat" - Shkup, në bazë të kontratës së nënshkruar paraprakisht me Qytetin e Shkupit.

VI. Mbikëqyrja

Mbikëqyrje mbi realizimin e Programit kryen Sektori për punë komunale.

VII. Dispozita përfundimtare

Ky program hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Këshilli i Qytetit të Shkupit.

A. MIRËMBAJTJA E SHTRATIT TË LUMIT VARDAR, LUMIT LEPENC DHE KANALEVE TË HAPURA NË TERRITORIN E QYTETIT TË SHKUPIT

1.	Pastrim manual i detajuar i vegjetacionit të ulët në shtratin e poshtëm të lumit Vardar, lumit Lepenc dhe kanaleve të hapura në territorin e Qytetit të Shkupit, ngarkimi dhe transportimi deri në deponi.	M2	30.000 x	59,00	=17.700.00
2.	Pastrim makinerik përgjatë pjerrësive dhe niveletës së shtratit të lumit Vardar, lumit Lepenc dhe kanaleve të hapura në territorin e Qytetit të Shkupit, ngarkimi dhe transportimi i sedimenteve dhe lymit deri në deponi.	M3	50.000 x	339,00	=16.950.000,00
3.	Pastrimi makinerik me buldozer i dheut dhe shtresave të bartura, për rrafshim të niveletës së shtratit të lumit Vardar dhe të degëve të tij në territorin e Qytetit të Shkupit.	M3	10.000 x	135,00	= 1.350.000,00
4.	Pastrim me makineri i vegjetacionit në lumin Vardar, degëve të tij dhe në kanalet e hapura në territorin e Qytetit të Shkupit. Bartja e materialeve me karroce në largësi prej 50 m ¹	M2	11.213.57 x	25,00	=280.339.25
5.	Sanimi i pjerrësirave në kanalet e rregulluara dhe rrjedhat e lumit dhe muret e Kejit me furnizimin, përgatitjen dhe vendosjen e blloqeve të gurit d = 30 cm me llaç çimentoje	M3	3.983,00 x	650.00	=2.588,950.00
6.	Pastrimi dhe fugimi i pjerrësirave të mbuluara me gurë	M2	500.00 x	3.130,00	=1.565.000,00
7.		M2	4.241.00 x	630.00	=2.671.830.00

GJITHSEJ

25.423.819.25

PASTRIMI I DEPONIVE INFORMALE

1.	Pastrimi makinerik i deponive informale Ngarkimi dhe transporti deri te deponia	M3	26.455.40 X	961.00	= 25.423.639.40
----	--	----	-------------	--------	-----------------

GJITHSEJ

25.423.639.40

REKAPITULAR

Mirëmbajtja e shtratit të lumit Vardar, degëve të
Saja – lumenjtë Lepenc, Treska, Serava dhe të
Kanaleve të hapura në territorin e Qytetit të
Shkupit

25.423.819.25

Pastrimi i deponive informale

25.423.639.40

GJITHSEJ	50.847.458.65
TVSH 18 %	9.152.542.56
TOTAL GJITHSEJ	60.000.001,21

KËSHILLI DREJTIUES

Kryetar

Aleksandar Patallovski

